



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/

*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

Data: 26.05.2025

Njoftim

Komisioni i angazhuar për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projektpropozimeve të OJQ-ve, sipas vendimit nr. 2/1811, të datës 12.5.2025, njofton se ka pranuar një aplikacion me postë, procesuar brenda afatit ligjor të thirrjes së shpallur me datën 22 prill 2025, *për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore për mbështetjen e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë*, por të ardhur me vonë në MASHTI.

Organizata është OJQ "ACCESS", por që nuk ka të regjistruar qendër mësimore dhe për këtë arsye nuk e plotëson kriterin bazë të thirrjes.

Gjithashtu aplikacioni i OJQ-së "Human Rights of Kosovo" ishte pranuar nga komisioni i thirrjes për projektet e OJQ-ve për IQ dhe pasi u pa që e njëjta ka aplikuar për mbështetjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian për vijimin e shkollës dhe arritjen e rezultateve, u mor në shqyrtim nga ne. Komisioni e trajtoi aplikacionin e organizatës në fjalë dhe u pa që organizata nuk figuron në listën e regjistrit të MASHTI për qendra mësimore. Pra kjo OJQ nuk ka të regjistruar qendër mësimore, prandaj e njëjta nuk e plotëson kriterin bazë të thirrjes.

Me respekt,

Komisioni vlerësues:

Merita Jonuzi, Kryesuese

Elhame Shabani, anëtare

Minire Gashi, anëtare

Tringa Visoka, anëtare e jashtme

Agon Haxhikadrija, anëtar i jashtëm